



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të përbashkët mbi nga Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.

Përfaqësuesi ligjor i palës njoftuese ka informuar Autoritetin e Konkurrencës me shkresën Nr. 580 Prot., të Autoritetit të Konkurrencës të datës 15.10.2018, lidhur me një transaksion që synon marrjen e kontrollit të përbashkët nga ana e Daimler FS dhe nga Volkswagen FS mbi Mobility Trader Holding GmbH.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Blerësi: Leonie FS DVB GmbH (Daimler FS) me seli në Gjermani, me Nr korporate HRB 762845, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt mbajtja dhe menaxhimi i aseteve dhe investimeve. Biznesi i kësaj shoqërie është mbajtja dhe administrimi i pasurive dhe interesave. Kjo shoqëri është degë e Daimler Grup.

Daimler AG, shoqëri aksionere, shoqëri gjermane me objekt të aktivitetit shfrytëzimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve dhe ofrimin e shërbimeve.

Grupi Daimler prodhon dhe shpërndan makina të pasagjerëve dhe automjeteve tregtare. Ai ofron gjithashtu shërbime financiare, duke përfshirë financimin, leasing-un, sigurimin dhe shërbimet e menaxhimit të flotës së automjeteve.

Shqipëri: Grupi Daimler është i pranishëm në Shqipëri në shitjen e automjeteve (makina, kamionë dhe autobusë) nëpërmjet një distributori, por nuk operon një platformë on-line për shitjen e automjeteve të përdorura të cilësisë së lartë në Shqipëri apo fokusuar në Shqipëri.

Shitësi: Volkswagen Financial Services Aktiengesellschaft (Volkswagen FS), shoqëri aksionere, me objekt të aktivitetit zhvillimi, shpërndarja dhe shlyerja e shërbimeve financiare të huaja dhe jo të huaja në Gjermani dhe jashtë saj, të cilat janë të përshtatshme për promovimin e biznesit të Volkswagen AG dhe shoqërive të lidhura të saj.

Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëri anonime, me objekt të shoqërisë prodhimi dhe shitja e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, aksesorëve të tyre dhe të gjitha pajisjeve makinave, mjeteve dhe produkteve të tjera teknike.

Grupi Volkswagen është aktiv në zhvillimin, prodhimin, shitjen dhe shpërndarjen e automjeteve motorike duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesorë, motorë dizel dhe motoçikleta.

Shqipëri: Grupi Volkswagen është aktiv në Shqipëri nëpërmjet pjesëve kryesore të biznesit të tij, shitjen dhe shpërndarjen e automjeteve motorike, duke përfshirë pjesë këmbimi dhe aksesorë të tjerë, motorët më naftë dhe motoçikleta.

Grupi Volkswagen ka tre entitete të themeluara në Shqipëri: Porsche Leasing SHPK; Porsche Mobility SHPK, Porsche Albania SHPK.

*Porsche Albania SHPK*¹ regjistruar më 05.07.2005 me objekt të aktivitetit shitje me shumicë dhe pakicë të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerjen e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve etj. Ortak me 100% të kuotave është Porsche Holding Gesellschaft m.b.H.

*Porsche Leasing SHPK*², regjistruar më 23.04.2013 me objekte të aktivitetit veprimtari të qirasë financiare, agjent në sigurime. Ortakë i kësaj shoqërie është Porsche Bank Aktiengesellschaft me 100% të kuotave.

*Porsche Mobility SHPK*³, regjistruar më 23.04.2013 me objekt të aktivitetit çdo formë e aktivitetit, veprimtarisë së qirasë operationale siç parashikohet nga dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Civil. Ortakë me 100% të kuotave është Porsche Bank Aktiengesellschaft.

Targeti: **Mobility Trader Holding GmbH (MT Holding)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të republikës Federale të Gjermanisë (HRB 192278) regjistruar në regjistrin tregtar të Gjykatës së Charlottenburg. Objekti i aktivitetit është menaxhimi i pasurive të veta, në veçanti ngritja e filialeve për të operuar një ose më shumë portale të internetit për shitjen e makinave të përdorura dhe ndërtimin dhe funksionimin e rrjeteve të të dhënave për të kombinuar ofertën dhe kërkesën në tregun e përdorur të automjeteve. Me anë të filialit të saj direkt në pronësi të plotë, Mobility Trader GmbH (MT GmbH) i ofron konsumatorëve në Gjermani një platformë on-line të shitjes së automjeteve të përdorura të cilësisë së lartë që quhet “heycar” (www.hey.car).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.

¹ Burimi: Statuti i shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është 707.911.000 lekë.

² Burimi: Statuti i shoqërisë. Kapitali themeltar është 69.950.000 lekë

³ Burimi: Statuti i shoqërisë. Kapitali i shoqërisë është 69.950.000 lekë

